

VENDIM
Nr. 488, datë 10.7.2019

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA
MINISTRI I SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME PARLAMENTIN, DHE
KONFEDERATËS ZVICERANE, TË PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA
ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM, QË VEPRON NËPËRMJET
AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI, DHE ORGANIZATËS PËR SIGURI
DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE), NËPËRMJET PREZENCËS SË SAJ
NË SHQIPËRI PËR MBËSHTETJEN NDAJ KUVENDIT DHE PROJEKTIN PËR
EDUKIMIN QYTETAR (PACEP)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, dhe Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, që vepron nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), nëpërmjet prezencës së saj në Shqipëri për mbështetjen ndaj Kuvendit dhe projektin për edukimin qytetar (PACEP), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË TË
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRI I SHTETIT PËR MARRËDHËNIET ME
PARLAMENTIN DHE KONFEDERATËS ZVICERANE TË PËRFAQËSUAR NGA
AGJENCIA ZVICERANE PËR ZHVILLIM DHE BASHKËPUNIM QË VEPRON
NËPËRMJET AMBASADËS ZVICERANE NË SHQIPËRI DHE ORGANIZATËS PËR
SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË (OSBE) NËPËRMJET PREZENCËS SË SAJ
NË SHQIPËRI PËR MBËSHTETJEN NDAJ KUVENDIT DHE PROJEKTIN PËR
EDUKIMIN QYTETAR (PACEP) 7f-09576

Faza fillestare dhe faza 1
(1 prill 2018–15 nëntor 2022)

Në përpjekje për të fuqizuar marrëdhëniet miqësore që ekzistojnë ndërmjet Shqipërisë, Zvicrës dhe OSBE-së,

Në vijim dhe në zbatim të Marrëveshjes Kuadër që lidhet me Bashkëpunimin Teknik, Financiar dhe Humanitar ndërmjet Këshillit Federal Zviceran dhe Qeverisë së Shqipërisë, të nënshkruar më 11 maj 2007 dhe të ratifikuar me anë të ligjit nr. 9801, të datës 13.9.2007,

Duke sjellë ndërmend se Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë ka mandatuar Prezencën e OSBE-së në Shqipëri me anë të vendimit të Përhershëm të Këshillit të saj, nr. 588, të vitit 2003 për të asistuar përpjekjet e Republikës së Shqipërisë për të zhvilluar institucione efikase demokratike dhe për të promovuar shtetin ligjor dhe të drejtat e njeriut në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira,

Respektimi për parimet demokratike dhe të drejtat themelore të njeriut — siç janë përcaktuar

në veçanti në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut — frymëzon politikat e brendshme dhe të jashtme të të tri Palëve dhe përbën një element thelbësor të barabartë me objektivat e kësaj Marrëveshjeje,

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (si në vijim e referuar si “AZZHB”-ja) dhe Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (si në vijim e referuar si “OSBE”-ja) kanë rënë dakord mbi termat dhe kushtet siç janë përcaktuar më poshtë.

Neni I

Kushtet e përgjithshme dhe përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë Marrëveshje, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat e mëposhtëm kanë kuptimin si në vijim:

a) “Palët” nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, Konfederatën Zvicerane dhe Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);

b) Pala zvicerane nënkupton Konfederatën Zvicerane të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AZZHB) e Departamentit Federal Zviceran të Punëve të Jashtme;

c) “AZZHB” nënkupton Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim të Ministrisë së Jashtme të Zvicrës, që përfaqësohet në Shqipëri nga Ambasada e Zvicrës;

d) Pala shqiptare nënkupton Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;

e) Pala e OSBE-së nënkupton Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë;

f) “Projekti” nënkupton “Projektin për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar” të financuar nga AZZHB-ja;

g) “Organizatë zbatuese” nënkupton Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Instituti Kombëtar Demokratik (IKD).

Neni II

Përgjegjësia zbatuese

1. Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin do të jetë agjencia homologe e projektit në përgjithësi, përmes së cilës Kuvendi është homologu përgjegjës për zbatimin e pjesës së projektit të Kuvendit (që nënkupton kryesisht rezultatin 1 dhe 2), siç përshkruhet në shtojcat, e caktuar nga ministri i Shtetit nëpërmjet kësaj marrëveshjeje.

2. AZZHB-ja do të jetë Autoriteti Ekzekutiv për aplikimin e Marrëveshjes dhe zbatimin e projektit. AZZHB-ja do të delegojë përgjegjësinë e zbatimit tek Ambasada Zvicerane në Shqipëri.

3. AZZHB-ja do të sigurojë një kontribut buxhetor shtesë në praninë e OSBE-së në Shqipëri dhe përveç kësaj, do t'i besojë IKD-së pjesën e zbatimit të projektit (shih shtojcën 2 — aktivitetet e OSBE-së dhe shtojcën 3 — aktivitetet e IKD-së).

Neni III

Qëllimet dhe objektivat

1. Qëllimi i përgjithshëm i këtij Projekti është: qytetarë më të ndërgjegjshëm e më të edukuar duke u fuqizuar të marrin pjesë aktive në procesin e vendimmarrjes në vend dhe të përfitojnë nga një Kuvend përfaqësues që funksionon më së miri.

2. Objektivat kryesorë të Projektit janë:

a) rezultati 1: administrata e Kuvendit i përmbush funksionet e saj në mënyrë efikase;

b) rezultati 2: parlamenti përmirëson funksionet e tij legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese me anë të përfaqësimit më të mirë të elektoratit, si dhe duke i kërkuar llogari degës ekzekutive;

c) rezultati 3: qytetarët bëhen pjesë e zhvillimeve demokratike në vend dhe përgatiten që t'u kërkojnë llogari deputetëve dhe të ushtrojnë ndikim te reformat.

Neni IV

Shtrirja dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Marrëveshja do të mbulojë aktivitetet e përcaktuara në Përshkrimin e Projektit (shtojcën 1), e cila përbën një pjesë integrale të Marrëveshjes, ku zhvillohen kryesisht në institucionet e mëposhtme të Shqipërisë:

- Kuvendi i Republikës së Shqipërisë; Administrata e Kuvendit, deputetët, komisionet dhe komitetet;
- Aktivitetet Zgjedhore Zyrtare që zhvillohen në Shqipëri;
- Organizatat e shoqërisë civile/joqeveritare.
- Marrëveshja mbulon periudhën e projektit midis datave 1 prill 2018 dhe 15 nëntor 2022 (faza fillestare dhe faza 1).

Neni V

Përgjegjësitë e AZZHB-së:

- a) Kontributi zviceran është një grant dhe do të përdoret për zbatimin e aktiviteteve të projektit, siç janë përcaktuar në Përshkrimin e Projektit (shtojca 1);
- b) Granti për fazën fillestare dhe fazën 1 arrin në maksimumin prej 6,350.000 frangash zvicerane (shtojcat 2 dhe 3);
- c) Ky grant nuk mund të alokohet për ndonjë qëllim tjetër. Çdo pjesë e papërdorur e grantit në përfundim të projektit do të jetë objekt i rimbursimit në AZZHB;
- d) Fondet e Projektit do të administrohen nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Shqipëri;
- e) Sigurojë fonde për prokurimin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve në përputhje me aktivitetet siç kanë rënë dakord Palët.

Neni VI

Përgjegjësitë e ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin do të:

- a) mundësojë alokimin e nevojshëm të buxhetit për të rimbursuar tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) të projektit në emër të IKD-së për shumën maksimale prej 60.000 frangash zvicerane (me fjalë gjashtëdhjetë mijë franga zvicerane).

Neni VII

Përgjegjësia e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

OSBE-ja do të:

- a) sigurojë udhëheqje strategjike dhe mbështetje për Kuvendin për të arritur objektivat e mësipërm, në përputhje me standardet dhe procedurat ndërkombëtare;
- b) dedikojë burime siç janë përshkruar në dokumentin e projektit për arritjen e objektivit në shtojcën 1;
- c) lehtësojë dialogun politik dhe grupin tematik të asistencës së Kuvendit ndërmjet partnerëve të zhvillimit dhe Kuvendit.

Neni VIII

Menaxhimi i Projektit

Projekti është një ndërmarrje e përbashkët ndërmjet ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, Kuvendit, AZZHB-së dhe OSBE-së.

Nga ana e palës zvicerane:

- AZZHB-ja është përgjegjëse për zbatimin e plotë të Projektit.
- AZZHB-ja mund të caktojë ekspertë të huaj dhe vendorë, afatgjatë dhe afatshkurtër, për të mbështetur zbatimin e Projektit.

- AZZHB-ja mund të caktojë edhe individë të tjerë dhe organizata vendore apo ndërkombëtare për të zbatuar pjesë të veçanta të Projektit.

Nga ana e palës shqiptare:

a) Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin:

- merr pjesë në Bordin Këshillimor të Projektit;
- siguron qasje në informacionin përkatës, duke përfshirë edhe të dhënat statistikore që çmohen të nevojshme dhe të dobishme për arritjen e objektivave të Projektit. Informacioni do të përdoret vetëm për qëllimet e Projektit. Çdo përdorim tjetër do të dorëzohet me lejen me shkrim të Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin.

b) Kuvendi i Shqipërisë:

- është përgjegjës për zbatimin e komponentëve të pjesës së Projektit të Kuvendit, sipas Përshkrimit të Projektit (shtojca 1);

- ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e aktiviteteve të pranuar të projektit;

- Mund të sigurojë informacione përkatëse për Ministrin.

Nga ana e OSBE-së:

- bashkëkryeson dhe merr pjesë në Bordin Këshillimor të Projektit;

- është përgjegjës për zbatimin e projektit të financuar nga kontributi buxhetor shtesë i fondeve zvicerane, siç janë përcaktuar në Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet OSBE-së, AZZHB-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, të nënshkruar më datën 23 maj 2018 (shtojca 3).

Neni IX

Mbështetja dhe koordinimi

1. Me qëllim që të sigurohet mbështetje e përgjithshme e Projektit, si dhe të trajtohen çështjet e politikave, do të themelohet Bordi Këshillimor i Projektit (BKP) që do të mbledhet dy herë në vit (në qershor dhe në nëntor). BKP-ja do të ketë kuorum vetëm atëherë kur do të jenë të pranishëm përfaqësuesit e të tri palëve dhe vendimet merren me konsensus.

2. BKP-ja do të përbëhet nga anëtarët e mëposhtëm me të drejtë vote:

- a) një përfaqësues i kryetarit të Kuvendit (bashkëkryesues);
- b) një përfaqësues nga ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin (bashkëkryesues);
- c) një përfaqësues nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri (bashkëkryesues);
- d) një përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit;
- e) një përfaqësues i OSBE-së në Shqipëri (bashkëkryesues).
- f) një përfaqësues i IKD-së në Shqipëri
- g) Të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Sipas nevojës dhe temës së Diskutimit, nga një Bashkëkryesues mund të ftohen aktorë të tjerë, me pëlqimin e ndërsjellë të të gjithë bashkëkryesuesve për të marrë pjesë në rolin e vëzhguesit. Vëzhguesit nuk kanë të drejtë vote.

Sekretariati i BKP-së përbëhet nga Partnerët Zbatues (OSBE-ja dhe IKD-ja), me rotacion, së bashku me të paktën një anëtar të personelit nga administrata e Kuvendit.

3. BKP-ja do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- a) do të mbështesë Projektin dhe do të japë zgjidhje për problemet e rëndësishme të zbatimit;
- b) do të lehtësojë gjetjen e zgjidhjeve miqësore të dallimeve të mundshme, në rast se ato dalin gjatë zbatimit të projektit;

- d) do të diskutojë e do të shkëmbejë informacione për me politikën e projektit dhe çështjet që lidhen me të;

- e) do të rishikojë rregullisht arritjet e projektit dhe do të japë komente në lidhje me zhvillimin e tij;

f) do të rishikojë dhe do të komentojë në lidhje me Termat e Referencës së vlerësimit të jashtëm të projektit apo misioneve rishikuese.

4. Mund të zhvillohet edhe ndonjë mbledhje e paparashikuar me kërkesën e njërit prej anëtarëve të BKP-së. Mbledhjet thirren nga Bashkëkryesuesi i Komisionit.

5. Nga ana e Parlamentit mund të mblidhet Komisioni Teknik në mënyrë *ad-hoc* (të posaçme, për të mbështetur dhe shoqëruar planifikimin dhe zbatimin e projektit.

Komisioni Teknik i Kuvendit përbëhet nga përfaqësues teknikë, si më poshtë:

- a. 1 (një) përfaqësues nga Zyra e Kryetarit të Kuvendit;
- b. 1 (një) përfaqësues nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit;
- c. 1 (një) përfaqësues nga Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- d. 1 (një) përfaqësues nga Ambasada Zvicerane në Shqipëri e 1 (një) përfaqësues nga OSBE-ja
- f. 1 (një) përfaqësues nga IKD-ja.

Komisioni Teknik i Kuvendit do të garantojë ndjekjen e projektit dhe do të kryejë detyrat e mëposhtme:

- a) do të mbështesë në çdo hap procesin e zbatimit dhe planifikimit të projektit;
- b) do të udhëheqë diskutimet teknike për të gjitha çështjet e rëndësishme;
- c) do të miratojë rezultatet kryesore të projektit;
- d) do të drejtojë zbatimin e projektit sipas prioriteteve të Kuvendit të Shqipërisë dhe do të koordinojë të gjitha aktivitetet e planifikuara.

Komisioni Teknik i Kuvendit mund të mblidhet mbi baza *ad-hoc* (të posaçme), sipas nevojës dhe me kërkesë të njërit prej anëtarëve të Komisionit Teknik të Kuvendit.

Sekretariati i Komisionit Teknik të Kuvendit përbëhet nga Partnerët Zbatues (OSBE-ja dhe IKD-ja), mbi bazë rotacioni me të paktën një anëtar të personelit të administratës së parlamentit.

Neni X

Raportimi dhe informacioni

Partnerët zbatues (OSBE-ja dhe IKD-ja) do të përgatisin raporte progresi çdo 6 muaj për AZZHB-në.

Palët do të informojnë menjëherë njëra-tjetrën në lidhje me çdo problem që identifikohet dhe që mund të ndikojë në zbatimin e projektit.

Neni XI

Monitorimi dhe vlerësimi

AZZHB-ja do të monitorojë zbatimin e projektit. Planifikohet një vlerësim i jashtëm për fazën përfundimtare të tij.

Neni XII

Prokurimi

Është mirëkuptimi reciprok i Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe AZZHB-së që kjo e fundit do t'i akordojë zbatimin e pjesëve të projektit drejtpërdrejtë IKD-së. Në parim, organizatat zbatuese (OSBE dhe IKD) janë përgjegjëse për prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punimeve ndërtimore që janë të nevojshme për zbatimin e projektit, duke zbatuar parimet e konkurrencës së drejtë (të lirë dhe të paanshme) ndërmjet ofertuesve potencialë, me qëllim që të arrihet efikasiteti në përdorimin e fondeve publike. IKD-ja do të japë çdo nënkontratë në përputhje me ligjin zviceran të prokurimit, siç specifikohet në kontratën ndërmjet IKD-së dhe AZZHB-së. Në rastet kur organizata zbatuese do të japë grante për institucionet shqiptare, të cilat prodhojnë mallra dhe shërbime, këto institucione do të japin nënkontrata të tilla në përputhje me ligjin shqiptar.

Neni XIII

Mallrat

1. Për kohëzgjatjen e projektit, mallrat që sigurohen nga fondet e AZZHB-së për përdorim në projekt do të mbeten në varësinë e pakufizuar të projektit dhe nuk do të devijohen nga projekti pa marrë më parë miratimin me shkrim të Ambasadës Zvicerane në Shqipëri, nëse kjo ka lidhje me ato pjesë të projektit që zbatohen nga IKD-ja.

2. Në rast se për ndonjë arsye projekti duhet ndërprerë, për përdorimin e mallrave të siguruar me kontributin zviceran do të vendoset me shkrim nga palët. Në këtë rast, AZZHB-ja nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi lidhur me këto mallra.

3. Në përfundim të projektit, të gjitha palët do të bien dakord me shkrim lidhur me sendet dhe mallrat që janë prodhuar me fondet e projektit.

Neni XIV

Ndërprerja e Marrëveshjes

1.1 Secila palë gëzon të drejtën të ndërpresë këtë Marrëveshje, duke dhënë gjashtë muaj para njoftim me shkrim për ndërprerjen e saj.

1.2 Në rast se secila palë konsideron se qëllimet e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të arrihen më ose që njëra nga palët e tjera nuk po i përmbush detyrimet e saj, atëherë pala tjetër gëzon të drejtën të pezullojë ose të ndërpresë këtë Marrëveshje, duke dhënë tre muaj përpara njoftim me shkrim. Pavarësisht nga sa më sipër, secila palë mund të ndërpresë këtë Marrëveshje me efekt të menjëhershëm në rastet e shkeljeve flagrante të Marrëveshjes. Shkelje flagrante do të thotë shkelje të rëndë të njërit prej objektivave kryesorë të kësaj Marrëveshjeje.

1.3 Në rast se si rrjedhojë e forcave madhore (fatkeqësi natyrore etj.) parandalohet ekzekutimi i marrëveshjes, secila palë mund të ndërpresë marrëveshjen me efekt nga momenti kur bëhet e pamundur përmbushja e saj.

2. Në rastin e ndërprerjes së parakohshme të kësaj Marrëveshjeje ose në përfundim të projektit, çdo fond i pashpenzuar brenda kuadrit të projektit do të kthehet AZZHB-së.

Neni XV

Modifikimet dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo modifikim apo përmirësim i kësaj Marrëveshjeje do të bëhet me shkrim dhe me pëlqimin e të gjitha palëve. Modifikimet hartohen në protokolle të veçanta dhe hyjnë në fuqi sipas parashikimeve të nenit XIX të kësaj marrëveshjeje.

Mosmarrëveshjet në lidhje me interpretimin apo zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje aktuale do të zgjidhen me anë të negociatave diplomatike ndërmjet palëve.

Neni XVI

Dispozita të përgjithshme

Brenda kontekstit të kësaj marrëveshjeje, palët nuk do të propozojnë as në mënyrë të drejtpërdrejtë as në mënyrë të tërthortë ndonjë përfitim të çfarëdo lloji natyre. Ata nuk do pranojnë propozime të tilla. Çdo sjellje korruptive ose e paligjshme përbën shkelje të rëndë të marrëveshjes në fjalë dhe e justifikon ndërprerjen e saj, dhe/ose edhe të çdo mase korrigjuese shtesë për rekurs në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm.

Duke u bazuar në performancën e projektit dhe në rezultatet e vlerësimit të jashtëm të përbashkët, Palët Kontraktuese do të vendosin nëse dhe në çfarë forme do të vazhdojnë bashkëpunimin përtej kësaj faze të projektit.

Neni XVII

Privilegjet dhe imuniteti

Asgjë në këtë apo në lidhje me këtë marrëveshje nuk përbën heqje dorë, në formë të shprehur ose të nënkuptuar, nga ndonjë prej privilegjeve dhe imunitetit që gëzon OSBE-ja, Ambasada e Zvicrës dhe personeli përkatës.

Neni XVIII

Shtojcat

Përshkrimet e Projektit (shtojca 1 — Përmbledhje e Projektit; shtojca 2 — Aktivitetet e OSBE-së dhe shtojca 3 — Aktivitetet e IKD-së) përbëjnë pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

Neni XIX

Kohëzgjatja dhe hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje mbulon periudhën nga data 1 prill 2018 deri më 15 nëntor 2022. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të brendshme të nevojshme për hyrjen në fuqi të marrëveshjes nga pala shqiptare, si dhe pas nënshkrimit nga të gjitha Palët pasi të jenë përmbushur të gjitha detyrimet kontraktuale.

Kjo Marrëveshje është hartuar në gjashtë kopje origjinale në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast dallimesh mbi mënyrën e interpretimit, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi. Palët konfirmojnë dhe nënshkruajnë këtë Marrëveshje në Tiranë, më 2019.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë

Elisa Spiropali

Ministër Shtetit

Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin

Për Qeverinë e Zvicrës

Ambasadori

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Për Organizatën e Sigurisë dhe Bashkëpunimit në Evropë

Kryetari i Prezencës

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Shtojca 1

Përmbledhje e Projektit të Mbështetjes së Kuvendit dhe Edukimit Qytetar (PACEP)

1. Orientimi strategjik

1.1 Konteksti i Shqipërisë

Sipas Kushtetutës së saj, Shqipëria ka një Kuvend njëdhomësh të zgjedhur nëpërmjet listave të mbyllura partiake me 140 anëtarë. Shqipëria ka nevojë për institucione politike përgjegjëse, transparente dhe përfaqësuese për tranzicionin e saj demokratik dhe synimin afatgjatë të saj për t'u futur në Bashkimin Evropian (BE). Duke pasur parasysh konfliktet e nivelit të lartë, Kuvendi i Shqipërisë është përpjekur gjatë viteve të fundit të ofrojë një forum për një dialog konstruktiv dhe të qëndrueshëm mes qeverisë dhe partive opozitare, bojkoteve parlamentare dhe protestave, të cilat i kanë bllokuar zhvillimin dhe kompromiset politike. Kapacitetet e Kuvendit në krijimin e ligjeve dhe rolin mbikëqyrës të tij janë të ulëta për shkak të sistemit të pafuqishëm që ekziston në administrimin e tij (të Kuvendit). Mungojnë të dhënat e paanshme e të bazuara në prova, si dhe dispozita e kërkimit për deputetët, pavarësisht se këto janë mjaft të rëndësishme për mirëfunksionimin e këtij të fundit. Për këtë arsye, deputetët mbështeten kryesisht vetëm në analizat e qeverisë, të cilat shërbejnë për të vlerësuar ligjet dhe politikat e saj, duke u dhënë kështu më shumë shkas polarizimeve politike në punën e tyre.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë i vitit 2018, thekson se: “kërkohen më shumë

përpjekje për të arritur një mbikëqyrje efektive, për të forcuar lidhjet me zonat elektorale, për të rritur transparencën dhe kodin etik, si dhe për të forcuar kapacitetin kërkimor të Kuvendit”¹. Mekanizmat e kapacitetit të Kuvendit dhe mbikëqyrjes efektive konsiderohen si treguesit kryesorë në përmbushjen e pjesës legislative të kriterëve politike të BE-së për anëtarësimin (Kriteret e Kopenhagën-it), ndërkohë që rritja e kapacitetit legjislativ është një faktor themelor për mundësinë e Shqipërisë në harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin *acquis Communautaire* të BE-së.

Për sa i përket **funksionit përfaqësues të Kuvendit**, ekziston një hendek i madh mes qytetarëve dhe këtij organi. Me qëllim që të përmbushë funksionin e tij përfaqësues, Kuvendi ka nevojë të përfaqësojë me efikasitet të gjithë qytetarët, duke i kushtuar vëmendjen e duhur edhe nevojave të veçanta të minoriteteve dhe grupeve në nevojë. Kontributi i organizatave të shoqërisë civile (OSHC-ve) në procesin legjislativ është i kufizuar. Në aspektin gjinor, 29% e të gjithë deputetëve janë gra, duke shënuar kështu edhe numrin më të lartë të grave deputete, në historinë post-totalitare të Kuvendit të Shqipërisë. Pavarësisht nga këto, faktet tregojnë se nevojitet më shumë punë për të fokusuar çështjet gjinore në procesin legjislativ dhe për të fuqizuar deputetët, në mënyrë që ata të kryejnë më mirë funksionin e tyre përfaqësues.

Pjesëmarrja e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes është tejet i kufizuar për realitetin shqiptar. Qytetarët vështirë se marrin informacion të qëndrueshëm lidhur me zhvillimet legislative në shtyp, kontaktet me deputetët janë të kufizuara, dhe instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejtë, të tilla si: referendumet apo peticionet nuk ekzistojnë pothuajse fare, ose pengohen nga barrierat administrative.

1.2. Shtrirja strategjike dhe rëndësia e asistencës zvicerane

Kjo asistencë vjen në një kohë mjaft kritike për të gjithë zhvillimin e vendit drejt integritimit në BE dhe nevojës për një rol më aktiv e më kuptimplotë të Kuvendit në zhvillimet e vendit. Projekti do të asistojë në adresimin e mangësive aktuale të Kuvendit dhe do të japë kontributin e tij në krijimin e një vizioni afatgjatë. Kjo është pikërisht koha e duhur për të punuar me Kuvendin, meqë kjo legjislaturë filloi vjet, pas zgjedhjeve të qershorit të vitit 2017, duke krijuar kështu një mundësi për të punuar me të njëjtin grup parlamentarësh deri në zgjedhjet e viti 2021.

Projekti përputhet me kornizën strategjike gjithëpërfshirëse të Shqipërisë, që e përcakton integritimin në BE si një prioritet kryesor të qeverisë, pikërisht aty ku funksionimi i përgjithshëm i Kuvendit përbën edhe një kërkesë politike të përcaktuar nga BE-ja. Përveç kësaj, projekti është koherent edhe me Informacionin mbi Bashkëpunimin Ndërkombëtar Zviceran 2017-2020. Projekti jep kontributin e tij në përmbushjen e synimit të përgjithshëm të Strategjisë së Bashkëpunimit Zviceran për Shqipërinë (2018-2021), dhe në veçanti synon në përmbushjen e Rezultatit 2, “Kuvendi kombëtar dhe këshillat bashkiakë e kryejnë më mirë funksionin e tyre mbikëqyrës dhe përfaqësues” dhe Rezultatit 3, “Qytetarët dhe shoqëria civile angazhohen në procesin e vendimmarrjes dhe i kërkojnë llogari qeverisë. Projekti është në përputhje me Synimin 16 të listës së Synimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SZHQ-ve) lidhur me institucionet efikase dhe të qëndrueshme, si dhe me SZHQ 5, që lidhet me barazinë gjinore dhe fuqizimin e rolit të grave.

Ky projekt kërkon të përdorë më së miri përvojën zvicerane përmes ekspertizës që ka parlamenti zviceran nëpërmjet Shërbimeve Parlamentare Zvicerane (SHPZ-ve). Tashmë janë vendosur edhe lidhjet me projektet për parlamentin të financuara nga AZZHB-ja (Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) në Maqedoni dhe Serbi, që do të fuqizohen edhe më tej gjatë fazës së zbatimit të projektit. Këtu nuk është parashikuar bashkëpunimi me sektorin privat, meqenëse fokusi i programit është një sektor që nuk menaxhohet nga aktorët privatë. Projekti parashikon një ndërhyrje në dy faza (8 vjet). Në përfundim të periudhës 8 vjeçare Kuvendi do t'i ushtrojë më mirë funksionet e tij legislative, përfaqësuese dhe mbikëqyrëse. Një Kuvend i fuqishëm është çelësi i përparimit të parimeve dhe kulturës demokratike përmes shoqërisë, dhe veçanërisht, kur ai ofron një kontribut të vërtetë drejt hyrjes së vendit në strukturat e BE-së. Qytetarët dhe organizatat e shoqërisë civile do kenë instrumente të reja dhe

¹ Raporti Vjetor i KE-së për Shqipërinë 2018, fq.8.

më shumë hapësirë për të ushtruar rolet e tyre në procesin e zhvillimit të vendit.

Përfituesit e drejtpërdrejtë të projektit janë të 140 deputetët (29% gra) — administratat e tyre (mbi 220 punonjës, 64% gra), qytetarët shqiptarë të cilët përfitojnë duke marrë pjesë në veprimtaritë e edukimit qytetar, organizatat e shoqërisë civile që angazhohen, si dhe institucionet e pavarura. Përfituesit jo të drejtpërdrejtë janë të 2.8 milionë qytetarët e vendit, të cilët përfundimisht do të përfitojnë nga një Kuvend më i mirë përfaqësuar e më funksional, dhe nga një shoqëri civile më aktive.

1.3. Rezultatet kryesore të fazës fillestare

Gjatë fazës fillestare u bënë një sërë vlerësimesh që synonin edhe natyrën dhe përcaktimin e ndërhyrjes². Rezultatet kryesore janë si në vijim: Perspektiva e deputetëve: Deputetët ngritën një mori shqetësimesh të përgjithshme. Që të gjithë ata cituan mungesën e kapacitetit të mjaftueshëm të personelit administrativ, si pengesë të punës së tyre. Shumë prej tyre përmendën teknologjinë e vjetërsuar, veçanërisht lidhur me punën e tyre legislative dhe qasjen ndaj informacionit. Përveç këtyre aspekteve, një temë tjetër që u ngrit me forcë nga opozita (pavarësisht se nuk u ngrit ekskluzivisht prej saj), ishte edhe mungesa e transparencës së procesit legjislativ. Shqetësime të tjera të ngritura prej tyre përfshinë edhe mungesën e kompetencës së shtypit në trajtimin e çështjeve parlamentare, mungesën e angazhimit të OSHC-ve me Kuvendin, nevojën e trajtimit të legjislacionit përmes këndvështrimit gjinor, si dhe nevojën e Kuvendit për të angazhuar mendimet e ekspertëve lidhur me çështjet gjithnjë në rritje të natyrës teknike gjatë debateve të komisioneve për të vlerësuar ndikimin (ekonomik) të vendimeve. Perspektiva e administratës parlamentare: Hendeqet e identifikuarra çuan në nevojën e pasjes së një plani strategjik gjithëpërfshirës e afatgjatë për Kuvendin, që do të ketë edhe një koncept menaxhimi korrespondues të burimeve njerëzore të modernizuara. Fuqizimi i Komisioneve parlamentare dhe puna me institucionet e pavarura do të përfshijnë domosdoshmërisht edhe përmirësimin e aftësive të personelit parlamentar, duke theksuar këtu edhe kapacitetet e pavarura dhe profesionale të kërkimit. Puna dhe performanca e administratës vështirësohet nga mangësitë teknologjike të infrastrukturës parlamentare, atëherë kur flasim për shërbimet arkivore apo legislative.

Perspektiva e shoqërisë civile dhe e qytetarëve: 80% e shtetasve shqiptarë që u pyetën besojnë se deputetët duhet të marrin përsipër përgjegjësitë e qytetarëve për t'u dhënë formë politikave publike. Këto rezultate flasin për një nivel shqetësues apatie. Meqenëse deputetët i përgjigjen kryesisht udhëheqësve të partive të tyre, dhe më pak qytetarëve e shqetësimeve të tyre, kjo ka çuar në krijimin e një niveli të lartë mosbesimi të qytetarëve ndaj Kuvendit. Përveç kësaj, informacionet e qëndrueshme lidhur me zhvillimet legislative përmes medias dhe qasja në procesin e vendimmarrjes janë një element që mungon për qytetarët. Kuvendi ka prezantuar një mekanizëm që shoqëria civile të angazhohet dhe të paraqesë gjetjet e saj në komisionet parlamentare dhe në proceset e hartimit të ligjeve. Megjithatë, përdorimi i një mekanizmi nuk është në nivel të kënaqshëm. Qytetarët nuk kanë instrumente të demokracisë së drejtpërdrejtë³ në duart e tyre, me anë të të cilave ata do të mund të ushtronin presion te qeveria ose vendimet e Kuvendit.

2. Vlerësimi i palëve të interesuara

Udhëheqja politike dhe administrative e Kuvendit ka filluar një proces reforme që do të formalizohet me pasjen e një plani strategjik gjithëpërfshirës dhe me një autonomi më të rëndësishme financiare. Si rrjedhojë, projekti paraqet një interes mjaft të madh për ta. Përcaktimi i prioritetit kryesor për fazën kryesore të projektit është tërësisht në përputhje me prioritetet e Kuvendit. Personeli administrativ është i motivuar që të luajë një rol më të rëndësishëm, në sajë të sistemit të përmirësuar (e-ligjet, biblioteka, arkivi, kërkimi), në vend, si dhe fuqizimit të kapaciteteve që ata do të përfitojnë nga projekti. Megjithatë, mbingarkesa potenciale e tyre për sa i përket kapaciteteve kohore do të kërkojë vëmendje të vazhdueshme, meqë administrata është

² Vlerësimi përfshin: Vlerësimin parlamentar, Vlerësimin e Riskut, Vlerësimin gjinor, Sistemin e E-legjislacionit në Kuvend, Reformën administrative dhe Burimet Njerëzore në Kuvend, Nevojën e arsimit dhe votuesve në Shqipëri, të Drejtat e Njeriut dhe Dialogun kombëtar.

relativisht e vogël në numër (1.87 personel për deputet).

Partitë politike janë palët e interesuara më të rëndësishme dhe ata do të përpiqen që deputetët t'u përgjigjen atyre. Prandaj, ata mund të mos jenë të interesuar të përmirësojnë transparencën dhe cilësinë e legjislacionit, si dhe lidhjet me elektoratin. Për deputetët e partisë qeverisëse mund të jetë e vështirë të luajnë një rol më të rëndësishëm, sidomos kur bëhet fjalë për proceset e mbikëqyrjes dhe hetimeve.

Nuk pritet të ketë rezistencë nga partitë politike opozitare, meqenëse projekti do të adresojë kryesisht çështje teknike, ashtu siç kërkohet edhe nga programi i BE-së, i cili shkon përtej politikave partiake. Po ashtu, organizatat zbatuese kanë një mandat të fortë dhe përvojë në punën e tyre me parlamentin dhe do t'i përdorin ato në funksion të zbatimit të saktë të projektit. Aktorët e shoqërisë civile (OSHC-të) do të përfitojnë në mënyrë të dyfishtë nga ky projekt: 1) Ata do të përfshihen më shumë në debatet dhe proceset parlamentare. 2) OSHC-të do të mbështeten edhe në arsimin e tyre qytetar dhe veprimtaritë zgjedhore, duke prezantuar aspekte të demokracisë së drejtpërdrejtë në sistemin politik shqiptar dhe duke kërkuar më shumë përgjegjësi.

OSBE-ja ka qenë partneri më i rëndësishëm ndërkombëtar i Kuvendit të Shqipërisë në 25 vitet e fundit. Ajo ka mbështetur Kuvendin në mandatin e saj dhe koordinon të gjithë aktorët e këtij nënsektori. OSBE-ja ka mbështetur krijimin e Aleancës Shqiptare të Grave Deputete dhe Kodin e Sjelljes së Deputetëve, në bashkëpunim me ODIHR-in. OSBE-ja po koordinon grupin e punës për zgjedhjet në Shqipëri. BE-ja e ka mbështetur Kuvendin përmes një projekti binjakëzimi gjatë dy viteve të fundit. BE-ja është një aleate e rëndësishme në mbështetjen e reformës, ashtu siç kërkohet edhe nga programi i hyrjes në BE. Që nga viti 2008, IKD)-ja (Instituti Kombëtar Demokratik) ka mbështetur iniciativën fuqizuese legjislative rajonale, duke ndarë përvojat krahasuese dhe praktikat më të mira për të ndihmuar Kuvendin të përdorë privilegjet institucionale dhe burimet e tij për të fuqizuar procedurën parlamentare dhe procesin legjislativ. Agjencitë e OKB-së, të tilla si: Gratë e OKB-së, kanë dhënë kontributin e tyre me ndërhyrje në objektiva të veçantë dhe në shkallë të vogël.

3. Objektivat

Ky projekt synon të ndjekë vizionin e mëposhtëm: Është tejet e rëndësishme për demokracinë në Shqipëri që të ketë një Kuvend që përfaqëson qytetarët, që përgatit ligje cilësore dhe që mbikëqyr ekzekutivin. Qytetarë të autorizuar dhe aktivë do të ndërveprojnë me Kuvendin dhe nivelet e tjera të qeverisë.

Qëllimi i përgjithshëm (ndikimi): Kur qytetarët janë më të ndërgjegjësuar e më të arsimuar, atëherë ata janë të autorizuar të marrin pjesë aktivisht në proceset e vendimmarrjes në vend, duke përfituar kështu edhe nga një Kuvend që funksionon më së miri e që është përfaqësues i tyre.

Rezultati 1: Administrata e Kuvendit i përmbush funksionet e saj në mënyrë efikase.

Rezultati 2: Kuvendi përmirëson funksionet e tij legjislative, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe përfaqësimin e qytetarëve duke përfaqësuar më mirë elektoratin dhe duke i kërkuar llogari organeve ekzekutive.

Rezultati 3: Qytetarët kanë hapësirën e tyre në zhvillimet demokratike të vendit dhe përgatiten t'u kërkojnë llogari deputetëve, si dhe të ndikojnë në reformat e vendit. Teoria e ndryshimit të këtij projekti "është që Kuvendi do të fitojë besimin dhe besueshmërinë e qytetarëve, dhe do të riafirmojë legjitimitetin e tij duke pasur një administratë më profesioniste dhe një transparencë më të madhe. Ai do të ketë funksione më të fuqizuara dhe do të ketë një ndërveprim më të përmirësuar e më sistematik me qytetarë të informuar. Një Kuvend më i përfaqësuar e më funksional do të japë kontributin e tij në zvogëlimin e polarizimit partiak, do të përmirësojë strukturën kaq të nevojshme të kontrollit dhe ruajtjes së ekuilibrit mes degëve të ndryshme të qeverisë, do të sigurojë një ekzaminim më të kujdesshëm për degën e ekzekutivit, do të prodhojë legjislacion cilësor e afatgjatë dhe do të përmirësojë demokracinë në vend në përgjithësi.

4. Strategjia e ndërhyrjes

PACEP-i do të ndërhyjë në tri fushat e mësipërme që janë përmendur në seksionin e objektivave. Lidhur me objektivin e parë dhe të dytë, është parashikuar përdorimi i qasjes së fuqizimit të sistemit, nën udhëheqjen e Kuvendit, ku projekti luan rolin e lehtësuesit dhe ku të

gjitha aktivitetet do të jenë pjesë e sistemit zyrtar. Fokusi i projektit do të jetë kryesisht në këto dy fusha të para, në fuqizimin e administratës së Kuvendit dhe në përmirësimin e funksioneve të tij bazë. Objektiva e tretë, ose ajo që ka të bëjë me edukimin qytetar, do të jetë pjesërisht në bashkëpunim me Kuvendin dhe pjesërisht nëpërmjet mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile për edukimin e votuesve të grupeve në nevojë dhe në çuarjen e programit të tyre për instrumentet e demokracisë së drejtpërdrejtë më përpara.

5. Fokusi në personelin administrativ. PACEP-i do të mbështesë Kuvendin në përkufizimin e kuadrit të tij strategjik të përmirësuar, operacional dhe financiar. Ky kuadër dhe ndryshimet sistematike³ do të garantojnë qëndrueshmërinë e projektit përtej zhvillimit të kapacitetit. Projekti adreson hendeqet dhe mangësitë e identifikuara gjatë Fazës Fillestare, të tilla si: autonomia e dobët financiare, plani strategjik, e-legjislacioni dhe modernizimi i sistemit teknologjik, fuqizimi i shërbimeve kryesore, të tilla si: kërkimi, biblioteka dhe sistemi arkivor, i cili përfundimisht do të shkrihet në një Institut Kërkimor Parlamentar të mirëfilltë (IKP)⁴.

Për sa i përket adresimit të autonomisë së dobët financiare, projekti do të ngrejë kapacitetet mbi rezultatet e arritura nga projekti IPA i BE-së për asistencën e parlamentit, i cili sapo ka përfunduar. “Është miratuar edhe një ligj mbi autonominë financiare dhe zbatim i këtij ligji do të mbështetet nga projekti.

Digjitalizimi i arkivave të Kuvendit dhe zbatimi i planit afatgjatë profesional për personelin e Kuvendit do të adresohen nga ky komponent.

6. Fokusi te deputetët. Këtu do të synohet fuqizimi i rolit të deputetit në monitorimin e aplikimit dhe vlerësimin e legjislacionit, që do të çojë në një metodologji më specifike të Vlerësimit Postlegjislativ (VPL) në Shqipërisë⁵. Sistemi e-Legjislacion meriton vëmendje duke pasur parasysh rolin qendror të tij si “shtyllë” e projektit. “*E-Legjislacioni*” i referohet paradigmës së kalimit të procesit të ligjbërjes nga një proces i bazuar në letra në një sistem të digjitalizuar të ligjbërjes. Projekti parashikon kontaktin me institucione të shumta përgjatë punës legjislative për të krijuar ndërfaqe mes tyre, me qëllim që të sigurohet menaxhimi i duhur i dokumenteve dhe ndarja e të dhënave me ta. PACEP-i do të fuqizojë dhe do të mbështesë marrëdhënien e Kuvendit me institucionet e pavarura dhe agjencitë rregullatore, që lidhen me mbikëqyrjen, përgjegjësinë dhe ruajtjen e pavarësisë së institucioneve. PACEP-i do të mbështesë komisionet “model” dhe do t’i ndihmojë deputetët me burime të reja dhe mjete që do të përmirësojnë efikasitetin e tyre.

7. Edukimi qytetar. PACEP-i do të fuqizojë angazhimin e shoqërisë civile me Kuvendin dhe do të mbështesë aktivitetet në terren dhe punën me median. Ai do të japë kontributin e tij në programet e veçanta që lidhen me edukimin e votuesve sipas programeve edukative të komisionit qendror të zgjedhjeve, duke e vënë theksin në veçanti në grupet në nevojë dhe grupet e marzhinalizuara, si edhe te gratë. Qytetarët do të përmirësojnë kuptueshmërinë e tyre për Kuvendin përmes medias dhe do të angazhohen drejtpërdrejtë në të. PACEP-i do të mbështesë përpjekjet e udhëhequra nga qytetarët për të përmirësuar integritetin e zgjedhjeve dhe për të zgjeruar pikat e qasjes në Kuvend nga ana e qytetarëve, në mënyrë që këta të fundit të marrin pjesë e të shprehin vullnetin e tyre të drejtpërdrejtë në procesin e vendimarrjes, duke përfshirë këtu edhe “demokracinë e drejtpërdrejtë” dhe referendumet. Projekti do të zbatohet nëpërmjet kontributit të programeve të OSBE-së, duke mbështetur kështu përpjekjet plotësuese të mandatit të tyre në Shqipëri (shih shtojcën 11). Një mandat (përmes një çmimi të drejtpërdrejtë, lutemi shihni shtojcën 10) do t’i jepet IKD (Institutit Kombëtar Demokratik).

Të dyja organizatat kanë fuqi politike dhe përvojë për t’u angazhuar me Kuvendin dhe edukimin qytetar, dhe Kuvendi i ka kërkuar zyrtarisht të dyja organizatave të zbatojnë projektin PACEP. Ndërhyrjet e planifikuara nga të dyja organizatat do të plotësojnë njëra-tjetrën. OSBE-ja dhe IKD-ja do të jenë kryesisht përgjegjëse për aktivitetet sipas:

Rezultatit 1 & 2. Fokusi kryesor i ndërhyrjes së OSBE-së do të jetë në lehtësimin e hartimit të

³ Sistemet e reja do të ngrihen ose do të lidhen me ato ekzistuese: E-ligji, arkivimi dhe kërkimi (sistemet e dokumentacionit), për shembull.

⁴ Modeluar sipas IKP-së në Maqedoni me financim të AZZHB-së dhe zbatuar nga IKD-ja.

⁵ Modeli zviceran mund të jetë një model që mund të merret në konsideratë.

planit strategjik për Kuvendin, në fuqizimin e punës së komisioneve dhe në ngritjen e sistemit e-legjislacion. Ndërsa fokusi i ndërhyrjes së IKD-së do të jetë fuqizimi i kapaciteteve të kërkimit për administratën e parlamentit dhe promovimi i edukimit qytetar. IKD do të nënkontraktojë me anë të dhënies së një granti një OJQ vendore, e cila do të jetë përgjegjëse për aktivitetet e edukimit qytetar, mbështetjen për zgjedhjet dhe mekanizmin e demokracisë së drejtpërdrejtë.

Rezultatit 3. Do të përdoret përvoja zvicerane përmes Shërbimeve Parlamentare Zvicerane (SHPZ). Fushat e mundshme të punës janë identifikuar si Vlerësimet Post-legislative (VPL- të), Edukimi dhe Puna me Publikun në Terren ose mbikëqyrja e saj. Projekti do të përcaktojë shkëmbime të rregullta me financime të qeverisë zvicerane për projektet në Shqipëri, veçanërisht me projektin “Bashki të Forta”, dhe me komponentin e mbulimit të këshillave lokalë me projektin “Lëviz Shqipëri”, që kanë si objektivat organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarët.

Qëndrueshmëria: Prioriteti i parë i udhëheqjes së parlamentit në PACEP është zhvillimi i një Plani Strategjik gjithëpërfshirës e shumëvjeçar. Pasja e një Plani Strategjik që i adreson të gjitha shërbimet dhe funksionet e Kuvendit e që drejtohet nga vetë ai (Kuvendi), do të jetë një instrument i rëndësishëm për qëndrueshmërinë e gjithë ndërhyrjeve të tjera të financuara. Ekziston një angazhim i fuqishëm e i qartë nga nivelet më të larta të Kuvendit, që përfshijnë Kryetarin e Kuvendit, Zëvendëskryetarin e Kuvendit, Sekretarin e Përgjithshëm dhe partitë politike që kanë qenë edhe homologë aktivë në përgatitjen e kësaj faze. Mbështetja e njësisë së projektit të Kuvendit ka funksione qëndrueshmërie, meqë është kjo njësi që do të ngrejë fondet për Kuvendin në fushën ndërkombëtare⁶. Partitë kryesore politike që përfaqësohen në parlament do të angazhohen në nivele të ndryshme të zbatimit dhe drejtimit të projektit. Asistenca që do t'i ofrohet komisioneve të përhershme do të përfshijë anëtarë të të gjitha partive politike. Kryetari i grupit kryesor opozitar në Kuvend do të jetë pjesë e Komisionit Drejtues. Mbështetja për edukimin qytetar do të bëhet përmes qendrës së re të trajnimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Temat transversale: Të dyja organizatat kanë kryer analiza të veçanta me baza gjinore dhe, për këtë arsye, i kanë hartuar ndërhyrjet mbi baza respektueshmërie. Përkatësia gjinore dhe përfshirja sociale janë diskutuar edhe më tej si pjesë integrale e dy protokolleve dhe janë reflektuar në kuadrin e (shtojcës 3). Përveç përkatësisë gjinore mbi baza normale, projekti do të promovojë edhe mënyra se si parlamenti mund të adresojë çështjet e barazisë gjinore duke punuar drejtpërdrejtë me strukturat përkatëse që tashmë ekzistojnë. Projekti do të promovojë legjislacionin përmes fokusit gjinor dhe atij të përfshirjes sociale, përveç mbështetjes për Aleancën e Grave Deputete.

5. Burimet

Buxheti i përgjithshëm për Fazën 1 arrin deri në 6.35 milionë franga zvicerane (duke përfshirë edhe 0.35 milionë për kredinë hapëse). Kostot e rezultatit 1, 2 dhe 3 do të ndahen mes kontributit të OSBE-së (2.67 milionë franga zvicerane) dhe mandatit të IKD-së (3.3 milionë franga zvicerane). Po ashtu, parashikohet edhe një rishikim i jashtëm për vitin 2021 — që do të bëhet nga AZZHB-ja në shumën prej 30.000 frangash zvicerane.

6. Monitorimi dhe Drejtimi

OSBE-ja dhe IKD-ja do të bëjnë monitorimin e bazuar në rezultate, vlerësimin dhe raportimin duke iu referuar kuadrin të projektit, planeve të punës dhe buxhetit përkatës. Mënyra e zbatimit të projektit është përcaktuar në përputhje me udhëzimet e OSBE-së dhe do të plotësohet nga kërkesat e AZZHB-së lidhur me raportimin/monitorimin. Do të përcaktohet më tej edhe një bord këshillues dhe një mekanizëm koordinues, që do të përfshijë të gjithë partnerët përmes marrëveshjes bilaterale të projektit.

Shtojca 3 - Projekti PACEP, për mbështetjen e Kuvendit dhe edukimin qytetar aktivitetet e IKD-së dhe kostot

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (Kuvendi), si një institucion kryesor në procesin e integritetit ka nevojë për një fazë të re reformash, që do të bëjnë të mundur që ai të përballet me

⁶ Kuvendi do të përcaktojë në planin strategjik të tij se në cilat fusha do të zhvillohen projektet. Deri më tani njësisë e projekteve mundi të merrte vetëm një projekt (binjakëzimi) IPA. Janë parashikuar më shumë projekte, megjithëse duhen fuqizuar kapacitetet e menaxhimit të projektit.

sfidat e hyrjes në Bashkimin Evropian (BE). Raporti vjetor i Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2018, thekson se kërkohen më shumë përpjekje për të arritur një mbikëqyrje efektive, për të forcuar lidhjet me elektoratin, për të rritur transparencën dhe kodin etik, si dhe për të forcuar kapacitetin kërkimor të parlamentit⁷. Kuvendi përballlet me një sërë sfidash, të cilat e pengojnë atë të ekzekutojë funksionet e tij legjislativ, përfaqësuese dhe mbikëqyrëse në një mënyrë efikase. Me pritshmërinë e rritjes së aktivitetit të Kuvendit për shkak të harmonizimit në vijim të legjislacionit me atë të *acquis communautaire*, numri i proceseve dhe procedurave të brendshme nevojitet të fuqizohet për të garantuar kështu suksesin e këtij procesi. Në të njëjtën kohë, parlamenti ka nevojë të ekuilibrojë nevojat për modernizim të teknologjisë dhe atyre investimeve në fushën e burimeve njerëzore, që janë të domosdoshme për ta sjellë Kuvendin më pranë qytetarëve të tij.

Strategjia afatgjatë e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (AZZHB) për Projektin e PACEP-it për Mbështetjen e Kuvendit dhe Edukimin Qytetar, përfaqëson një mundësi historike për Kuvendin, e cila nuk duhet humbur. Me anë të programit të saj të parë e të plotë parlamentar në Shqipëri, IKD-ja është e kënaqur të kryejë mbështetjen teknike që rrjedh si pasojë e punës së saj të gjatë të bashkëpunimit me parlamentet e mbi 60 vendeve në botë.

Aktivitetet kryesore

Në dy vitet e para, IKD-ja do ta fokusojë asistencën e saj në shërbimet e kërkimit, bibliotekës, kontaktit me publikun dhe botimeve, si dhe Sektorit të Projekteve, duke modernizuar shërbimet, duke përditësuar proceset e punës dhe duke rritur kapacitetet për punonjësit aktualë, duke prokuruar pajisjet elektronike, programet kompjuterike dhe mobilimin e nevojshëm. IKD-ja do të krijojë një program praktike për administratën për të zbutur mangësitë aktuale të kapacitetit të personelit dhe do të marrë pjesë në një ushtrim të përgjithshëm për planifikimin strategjik, që do të bëhet nga OSBE-ja, për të planifikuar në përputhje me rrethanat themelimin e Institutit Parlamentar. Do t'i jepet mbështetje e gjerë edhe Këshillit Drejtues, me qëllim që të përgatitet për themelimin e këtij instituti, që do të përcaktojë procesin pjesëmarrës të planifikimit strategjik të Institutit Parlamentar. Për të matur zhvillimin e arritur përmes projektit PACEP, IKD-ja do të drejtojë edhe një sondazh për të konstatuar mendimin e publikut lidhur me transparencën për organin legjislativ dhe për të parë se sa i hapur është ky organ në lidhje me publikun. Do të sigurohet asistencë e përditshme në vend për shërbimet e identifikuar.

Aktivitetet kryesore përfshijnë:

1. Shërbimin kërkimor: programi mbikëqyrës për kërkuesit aktualë me drejtuesit e Instituteve Parlamentare nga Sllovakia/Republika Çeke/Maqedonia; Bursë kërkimore në Sllovakë; zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Kërkimit, asistencë e dhënë gjatë punës.

2. Shërbimin bibliotekar: program mbikëqyrës; vizitë studimore në parlamentin sllovak dhe maqedonas; zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Bibliotekës, prokurimin e pajisjeve për skanimin e barkodeve dhe pajisjeve të sigurisë, pajisje elektronike (pajisje fotokopjimi/skaner me shumë funksione, server për të ruajtur LMS/RMS), libra dhe abonime, asistencë e dhënë gjatë punës

3. Edukimi/Kontakti me Publikun: program mbikëqyrës; Bashkëpunim në Parlamentet e Mbretërisë së Bashkuar dhe Maqedonisë; plani për kontaktin me publikun (shumëllojshmëria e turneve parlamentare dhe materiale për edukimin qytetar), prokurimin e hartimit të programeve kompjuterike, zhvillimi dhe përgatitja e materialeve të ndryshme edukative, blerje projektori/ekrani dhe sistemit rrethues me audio, asistencë e dhënë gjatë punës.

4. Sektori për Projektet: trajnime/asistencë e dhënë gjatë punës, trajnime mbi menaxhimin e ciklit të projektit, mbështetje në zbatimin e dokumenteve strategjike.

5. Administrimi i programit të Praktikës (stazhi): 5 stazhierë (vitin e parë) dhe 7 stazhierë (vitin e dytë) të rekrutuar çdo vit për të mbështetur sektorët e kërkimit, bibliotekës, kontaktit me publikun/shërbimeve edukative, asistencë e dhënë gjatë punës

6. Planifikimi strategjik i përgjithshëm: angazhimin që do të marrë pjesë në procesin e planifikimit strategjik të udhëhequr nga OSBE-ja, për të siguruar themelimin afatgjatë të Institutit

⁷ Raporti Vjetor i KE-së për Shqipërinë 2018, f. 8.

Parlamentar.

d) Këshilli Drejtues⁸: vizita studimore në parlamentin maqedonas, çek, Kongresin amerikan; angazhimi i ekspertit për të zhvilluar procedurat e brendshme, asistencë e dhënë gjatë punës

e) Planifikimi Strategjik për Institutin Parlamentar: angazhimi i ekspertit(-ëve), seminare; mbështetje për grupin e punës; asistencë e dhënë gjatë punës (pas miratimit të Planit Strategjik për Administratën);

f) Transparenca legjislative dhe qasja e publikut: sondazh publik, ngritja e grupit të punës për transparencën dhe mbështetja e tij, asistencë në zhvillimin e planit të veprimit për transparencën, asistencë e dhënë gjatë punës;

g) Qendra e vizitorëve: adaptimi dhe rinovimi i ambientit të përzgjedhur, prokurimi pajisjeve dhe mobilie, zhvillimi dhe përgatitja e materialeve promovuese, asistencë e dhënë gjatë punës

Duke supozuar që janë vënë themelet për ngritjen e Institutit Parlamentar, gjatë vitit të tretë e të katërt, IKD-ja do të fokusojë asistencën e saj në themelimin dhe zhvillimin e Institutit Parlamentar, që do të ketë edhe qendrën kërkimore, bibliotekën, kontaktin me publikun dhe personelin e edukimit. Kjo do të përfshijë zhvillimin e përshkrimeve të punës, zhvillimin e procesit rigoroz të rekrutimit, monitorimit dhe procedurave vlerësuese, rekrutimin dhe trajnimin e personelit. Programet e mbikëqyrjes do të vazhdojnë të angazhojnë personel të rekrutuar së fundmi dhe do të zhvillojnë edhe më tej cilësinë e produkteve dhe shërbimeve. Për personelin e rekrutuar së fundmi do të organizohen vizita studimore për t'ju dhënë atyre një ekspozim ndaj operacioneve, produkteve dhe shërbimeve të instituteve të ndryshme parlamentare. Do të jepet edhe asistencë e përditshme gjatë procesit të punës.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit të tretë e të katërt do të përfshijnë:

Instituti Parlamentar

2. Shërbimin kërkimor: program mbikëqyrës; bursë kërkimore në parlamentin maqedonas; përmirësimin e programeve kompjuterike; prokurimin e pajisjeve elektronike (kompjuterëve për IP-në, pajisjet me shumë funksione printer/fotokopje/skaner, server), mobilie; prokurimi i abonimeve, asistencë e dhënë gjatë punës.

3. Shërbimin bibliotekar: përmirësimin e programeve kompjuterike, prokurimin e librave, asistencë e dhënë gjatë punës.

4. Edukimi/kontakti me publikun: program mbikëqyrës, zhvillimi dhe përgatitja e materialeve të ndryshme edukative, asistencë e dhënë gjatë punës.

5. Planifikimi Strategjik për Institutin Parlamentar: angazhimi i ekspertit/-ëve, mbështetje për grupin e punës, takime vjetore.

6. Programi i Stazhierëve për Administratën (stazhi): 10 stazhierë çdo vit që do të mbështesin sektorët e kërkimit, bibliotekës, kontaktin me publikun/shërbimet edukative.

7. Këshilli drejtues/Bordi Këshillues: angazhimi i ekspertit për të mbështetur punën e Këshillit Drejtues, dhe themelimin e Bordit Këshillues.

8. Aktivitete të përgjithshme për personelin e IP-së: vizita studimore në parlamentet slloake, çeke dhe maqedonase, sigurimi i ekspertëve të ndryshëm, asistencë e dhënë gjatë punës.

9. Qendra e vizitorëve: zhvillimi dhe përgatitja e materialeve promovuese, asistencë e dhënë gjatë punës

Aktivitete të tjera

5. Sektori për Projektet: program mbikëqyrjeje, trajnime.

6. Transparenca legjislative dhe qasja e publikut: sondazh publik, asistencë për grupin e punës, zhvillimi i Planit të Veprimit për Transparencën Legjislative, konferencë kombëtare për qasjen legjislative dhe transparencën

Personeli

IKD-ja do të angazhojë një ekspert ndërkombëtar për zhvillimin e parlamentit, i cili do të

⁸ Modeluar sipas Institutit Parlamentar në Maqedoni. IKD-ja propozon të formohet Këshilli Drejtues për të mbikëqyrur themelimin dhe zhvillimin e IP-së së Shqipërisë duke ndihmuar në formimin e politikave dhe duke monitoruar zhvillimin me synime dhe etapat e themelimit të tij. Ai përbëhet nga përfaqësues të shumicës së partive politike në parlament — duke përfshirë si opozitën ashtu edhe qeverinë — si dhe zyrtarët e administratës parlamentare, Këshilli Drejtues do të sigurohet që Kuvendi të informohet lidhur me zhvillimin e IP-së, si ofrues shërbimesh.

menaxhojë këtë program dhe do të sigurojë asistencën ditore gjatë punës për shërbimet e zgjedhura parlamentare në vitin e dytë të zbatimit të projektit. Menaxheri i programit parlamentar do të mbështetet nga dy anëtarë vendorë të personelit, që do të caktohen për të mbështetur aktivitetet e përgjithshme të projektit. Personeli i projektit do të asistohet nga kolegët e IKD-së në rajon, si dhe nga një mori kolegësh parlamentarë dhe ekspertësh nga parlamentet e Sllovakisë, Republikës Çeke, Polonisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë, si edhe nga ekspertë vendorë. Drejtori i IKD-së do të mbikëqyrë zbatimin e përgjithshëm të projektit dhe do të sigurojë bashkëpunimin dhe partneritetet me homologët vendorë e të huaj që punojnë me parlamentin.

Metodologjia

Gjatë zhvillimit dhe zbatimit të programeve të saj, IKD-ja e vë theksin në qasjen përfshirëse dhe pjesëmarrëse për të ngritur partneritetet dhe për të krijuar një qëndrueshmëri afatgjatë. IKD-ja mbështet zhvillimin e partnerëve të saj duke asistuar që ata të përfitojnë aftësi dhe njohuri të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të pranuar dhe për një qëndrueshmëri graduale. Duke përdorur një kombinim të përshtatshëm të mbikëqyrjes, bursave dhe programeve të stazhierëve, asistencën e dhënë gjatë punës dhe bashkëpunimin me parlamentet që tashmë i kanë themeluar institutet e tyre parlamentare, si dhe me një planifikim të mirë organizuar dhe procedura vlerësimi, të gjitha aktivitetet do të zbatohen në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin në Shqipëri dhe në koordinim me praninë e OSBE-së në Shqipëri.

Rezultatet e pritshme

Megjithatë asistencë gjatë dy viteve të para të zbatimit të projektit fokusohet kryesisht në shërbimet ekzistuese dhe burimet njerëzore, rezultatet e pritshme përfshijnë përmirësimin e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga Shërbimi Kërkimor dhe ai Bibliotekar; shumëllojshmëria e produkteve dhe shërbimeve të ofruara për deputetët, personelin parlamentar dhe qytetarët, dhe rritjen e kontaktit parlamentar duke hapur edhe një Qendër për Vizitorët, zgjerimin/shumëllojshmërinë e tureve me guidë dhe vënien e themeleve ligjore e operacionale për ngritjen me sukses të Institutit Shqiptar Parlamentar.

Vitet tre dhe katër do të rezultojnë me një performancë pilot për Institutin Parlamentar, produktet dhe shërbimet e të cilit do të vlerësohen me rigorozitet nga kolegët e tyre të parlamenteve të tjera për të siguruar cilësinë më të mirë të mundshme. Pas themelimit të IKD-ja do të blejë pajisjet e nevojshme dhe mobilitet për të mobiluar plotësisht mjediset e Institutit Parlamentar.

AKTIVITETET KRYESORE TË PROGRAMIT

AZZHB Rezultati 1: Administrata e Kuvendit aftësinë e saj për të përmbushur funksionet e Kuvendit në mënyrë efikase.

1. IKD rezultati 1: Kuvendi përcakton dhe ndjek një plan strategjik për të ngritur Institutin Parlamentar që kryen shërbime të pavarura e të paanshme kërkimore, bibliotekare dhe arkivore, dhe
2. IKD rezultati 2: Rritet kapaciteti i shërbimeve administrative parlamentare (Kërkimi, Biblioteka, Media/Kontakti me Publikun, Sektori për Projektet, Shërbimi Botues, etj..) në përputhje me planin strategjik.

Fushat e Ndërhyrjes	Aktivitetet	Rezultatet	Buxheti ³ në dollarë amerikanë (dhjetor 2018-2022)
Shërbimi Kërkimor dhe i Analizës Gjatë vitit të parë dhe të dytë të programit asistencë ndaj shërbimit kërkimor do të fokusohet kryesisht në përmirësimin e cilësisë dhe llojeve të produkteve kërkimore në dispozicion të deputetëve, në planin afatshkurtër, përmes mbështetjes së personelit, trajnimeve individuale dhe trajnimeve lidhur me rritjen e kapaciteteve të personelit ekzistues. Projekti do të sigurojë mbështetje dhe trajnime gjatë punës për kërkuesit, si ata ekzistues, dhe për ata që do të rekrutohen, si dhe për stazhierët për të gjithë kohëzgjatjen e projektit. Gjatë vitit të tretë dhe të katërt, IKD-ja do ta fokusojë asistencën në themelimin dhe zhvillimin e Institutit Parlamentar,	• Program mbikëqyrës për personelin ekzistues kërkimor nga Drejtorët e IP-ve të vendeve të Evropës Lindore dhe Ballkanit • Perëndimor (Republika Çeke, Sllovakia, Maqedonia/Mali i Zi) • Hartimi i planeve të performancës individuale për secilin kërkues për të rritur mbështetjen • Bursa në IP-të e vendeve të Evropës Lindore dhe parlamentet e Ballkanit • Perëndimor për kërkuesit • Abonimet për të zgjedhur bazat e të dhënave* të tillasi • Rishikime të rregulloreve të shërbimit të brendshëm, përmirësim	• Plan zhvillimi profesional për të gjashtë kërkuesit aktualë • Kërkuesit thellojnë aftësitë e tyre kërkimore përmes ekspozimit ndaj një sërë teknikash kërkimore, produkteve kërkimore, dhe shkrimit analitik e të paanshëm • Kërkuesit përdorin të dhëna të besueshme nga baza zyrtare të dhënash/abonimes h • Fusha e shërbimit kërkimor zgjerohet, me një ndarje të përmirësuar të punës që mundëson specializimin mes tyre dhe krijon më pak mbivendosje	300,571

3. Sipas komponentit të PACEP-it për shoqërinë civile, IKD-ja do të japë një grant për një organizatë të shoqërisë civile që do t'i përgjigjet Rezultatit 3 të PACEP-it: Qytetarët janë të përgatitur më mirë për t'ju kërkuar llogari deputetëve dhe për të ndikuar tek reformat. Shuma e përgjithshme e grantit dhe administrimit të saj arrin në 768,134 dollarë amerikanë.

3. Sipas komponentit të PACEP-it për shoqërinë civile, IKD-ja do të japë një grant për një organizatë të shoqërisë civile që do t'i përgjigjet Rezultatit 3 të PACEP-it: Qytetarët janë të përgatitur më mirë për t'ju kërkuar llogari deputetëve dhe për të ndikuar te reformat. **Shuma e përgjithshme e grantit dhe administrimit të saj arrin në 768,134 dollarë amerikanë.**

që do të përbëhet nga sektorët e kërkimit, bibliotekës, kontaktit me publikun, botimeve dhe personelit edukativ. Kjo do të përfshijë hartimin e përshkrimeve të punës, zhvillimin e rekrutimit rigoroz dhe procedurat e monitorimit e vlerësimit, rekrutimin dhe trajnimin e personelit, përcaktimin e proceseve të punës dhe procedurave institucionale. Programet e mbikëqyrjes do të vazhdojnë të angazhojnë personelin e ri të rekrutuar dhe rritjen e cilësisë së produkteve dhe shërbimeve. Do të organizohen vizita studimore për rekrutet e rinj, që ata të ekspozohen ndaj operacioneve, produkteve dhe shërbimeve të institucioneve të ndryshme parlamentare. Do të sigurohet asistencë ditore gjatë punës. Shërbimi bibliotekar Shërbimi bibliotekar i Kuvendit duhet të modernizohet për të pasur një shumëllojshmëri shërbimesh dhe produktesh që i ofron deputetëve dhe administratës parlamentare, si dhe duhet përmirësuar siguria e fondit.	dhe qartësim të rregullave për përgatitjen e dokumenteve kërkimore dhe përshkrime pune për të shmangur mbivendosjen me departamente të tjera - Zhvillimin e një sistemi menaxhimi për kërkesat dhe bazës së brendshme të të dhënave për projektet kërkimore - Ngrihet sistemi i menaxhimit të kërkesave dhe sistemi i menaxhimit të bibliotekës - Përmirësohet katalogimi i bibliotekës dhe procesi i indeksimit sipas versionit më të fundit të thesarit shumëgjuhësh të BE-së	- Shërbimi Kërkimor zgjeron fushën e kërkimit me një fokus në procesin e hyrjes në BE - Cilësia e kërkimit monitorohet dhe rishikohet duke u bazuar në vlerësimet reaguese - Shërbimi Kërkimor organizon diskutime mbi politikën dhe konferenca mbi tema të zgjedhura, në bashkëpunim me komisionet parlamentare - Shërbime të shumëllojshme dhe produkte në dispozicion të deputetëve, komisioneve dhe shërbimit kërkimor, duke përfshirë sistemin më të ri të tërheqjes, qasjen në bazat elektronike të të dhënave, informacionin dhe	159,077
--	--	--	----------------

*Abonimet mund të përfshijnë Oxford Reference, Oxford Analytica, Sitewise, Bazën e të dhënave të BE-së për Shkëmbimet Ndërparlamentare (IPEX), Kërkime në shkencat Shoqërore(SSRNetwork), Economist Intelligence Unit, EU Prelex1 dhe Prelex2, OECD e të ngjashme

	(EuroVoc) dhe ruajtjen e bazës elektronike të të dhënave për materialet e bibliotekës • Prezantohet teknologjia e skanimit të barkodit për mbrojtjen e fondit të librit • Bursë në bibliotekat e parlamentit sllovak dhe maqedonas (2 javë/person), në mënyrë që bibliotekarët të mësojnë rreth procesit të punës dhe menaxhimit të platformave RMS dhe LMS • Zgjerim i fondit të bibliotekës • Abonime në revistat periodike dhe bazat shtesë të të dhënave, të tilla si: LexisNexis, Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Bibliotekave (IFLA), IPU, Britannica e të tjera. • 5 stazhierë në vitin e parë dhe 7 në vitin e dytë, që zgjidhen përmes një aplikimi meritore dhe procesit të intervistës • Trajnim për menaxhimin e ciklit të projektit • Trajnim për planifikimin strategjik • Mbështetje për zhvillimin e projektit dhe ngritjen e fondeve • Ngritjen e sistemit të monitorimit dhe	shërbimet e referencës • Koleksion i sigurt bibliotekar dhe zgjerim i fondit të bibliotekës me libra • Menaxhim i përmirësuar i koleksionit dhe mbështetje për kërkesat e deputetëve • Stazhierët përfitojnë aftësi dhe njohuri përmes mbikqyrjes së rregullt të personelit të projektit dhe ekspertit dhe mund t'u japin deputetëve shërbime të nivelit të lartë • Personeli i sektorit i mirë trajnuar dhe i përgatitur për të kryer detyrat e tij • Monitorimi i brendshëm lidhur me projektin dhe zbatimin e sistemit të vlerësimit • Sektori koordinon punën e grupeve të ndryshme të punës që kanë detyrën për të zhvilluar dhe zbatuar dokumentet e ndryshme strategjike • Sektori përgatit të në mënyrë efikase	41,685 79,780 170,160
Programi i stazhit në Administratë (Stazhi) Duke pasur parasysh nevojat e Kuvendit për personel të kualifikuar shtesë, IKD-ja do të lehtësojë një program vjetor stazhi, për stazhierët që do të shërbejnë kryesisht në sektorin e kërkimit, bibliotekës, edukimit të publikut dhe shërbimeve botuese. Mbështetja për Sektorin e Projekteve Sektori për projektet është një sektor kyç në zhvillimin dhe koordinimin e zbatimit të dokumenteve të parapara strategjike, si dhe koordinimit të aktiviteteve të ndryshme të donatorëve dhe partnerëve. Mbështetja për sektorin e projekteve do të përfshijë mbikëqyrjen në punë për zhvillimin e propozimeve të projektit, ndihmën në hartimin e kuadrit për koordinimin e asistencës së donatorëve, përgatitjen e udhëzimeve për raportimin e donatorëve, mbikëqyrjen e zbatimit të projektit, udhëzime lidhur me ngritjen e grupeve të brendshme të punës; mbështetje për planin vjetor të sektorit të kontaktit me publikun dhe të tjera. Këshilli Drejtues dhe			

Bordi Këshillimor i Projektit Këshilli Drejtues do të udhëheqë dhe mbikëqyrë themelimin dhe zhvillimin e Institutit Parlamentar të Shqipërisë. Mbështetja e Kuvendit për themelimin e Institutit Parlamentar Duke pasur parasysh miratimin e planit strategjik të Kuvendit, duhet ngritur një grup pune që do të ndërmarrë planifikimin strategjik për themelimin e IP-së përmes një procesi disa vjeçar duke filluar që në fillim të vitit të dytë të projektit e në vazhdim, sipas udhëzimeve të Këshillit Drejtues.	- vlerësimit - Trajnim për ngritjen e fondeve dhe raportimin - Themelimi i Këshillit Drejtues - Përcaktimi i rregullave të punës, procedurave dhe planeve vjetore - Përvojat e të mësuarit krahasues nëpërmjet shkëmbimeve dhe vizitave studimore (Vizitë studimore në Shërbimin e Kongresit Amerikan, Institutin Parlamentar çek, Institutin Parlamentar maqedonas) - Mbështetje për hartimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mes Kuvendit të Shqipërisë dhe AZZHB-së/IKD (i nënshkruar) - Themelimi i Bordit Këshillimor për Projektet⁴ që do të këshillojë dhe do të sigurojë orientim strategjik për Këshillin Drejtues - Ngritja e grupit të punës që do të ndërmarrë planifikimin strategjik për themelimin e IP-së dhe koordinimin e tij të mëtejshëm - Seminar trajnues mbi planifikimin strategjik dhe takimet vijuese të grupit të punës për të përcaktuar	propozime projekti dhe ngritje fondesh - Këshilli Drejtues funksionon si një organ qeverisës ndër-partiak që në fillim të projektit - KD-ja siguron mbështetjen e gjerë politike për IP-në dhe qëndrueshmërinë e tij - Memorandum Mirëkuptimi mes Kuvendit të Shqipërisë dhe AZZHB-së/IKD-së (i nënshkruar) - Identifikimi i anëtarëve të Bordit Këshillimor dhe formimi i grupit të punës në 2021 - Miratimi i Planit Strategjik për fazën e parë të IP-së miratuar nga udhëheqja e Kuvendit, përfshirë këtu edhe sistemin rigoroz të monitorimit dhe vlerësimit - Ndryshimi i një sërë rregulloresh të brendshme që nevojiten për themelimin e IP-së - Përgatitjen e përshkrimeve të reja të punës për personelin e IP-së - Rekrutimi i personelit cilësor e të motivuar të IP-së sipas sistemit merit	234,973
--	--	--	----------------

	fushën dhe funksionet e IP-së dhe llojin e produkteve/shërbimeve të tij • Takimet gjysmë-vjetore të vlerësimit për të zhvillimet rreth IP-së • Krijimi i përshkrimeve të punës për personelin e IP-së • Zhvillimi i sistemit rekrutues rigoroz e meritës • Hartimi i procedurave dhe protokolleve të brendshme të IP-së • Rekrutimi i personelit • Trajnime gjatë punës • Pas themelimit, vizita studimore në Maqedoni, Sllovaki, Republikën Çeke, bursë në parlamentin maqedonas	• Personeli i IP-së punon sipas standardeve më të larta profesionale • Hartimi dhe zbatimi i planeve të rregullta vjetore	
--	--	--	--

Fushat e Ndërhyrjes	Aktivitetet	Rezultatet	Buxheti në dollarë amerikanë (dhjetor 2018-2022)
Edukimi dhe Shërbimet e Kontaktit me Publikun Si pjesë integrale e Institutit të ardhshëm Parlamentar, IKD-ja do të ndihmojë në fushën e kontakteve me publikun dhe atë të botimeve, lidhur me përmirësimin e dhe zgjerimin e llojit të mundësive edukative dhe materialeve që ata përgatisin për qytetarët dhe personelin.	- IKD-ja do të bëjë konsultime ekspertësh për të zhvilluar një plan operacional për kontaktin me publikun - Përgatitja e dokumenteve për llojet e ndryshme të guidave parlamentare (legjislative, historike, artistike, etj...) në bashkëpunim me institucionet e ndryshme - Përgatitja e materialeve për edukimin qytetar (broshura, postera, fletë-palosje, video klipe, etj...) për audiencat e ndryshme për të promovuar punën dhe rolin e Kuvendit - Promovimi i guidave parlamentare - Vizitat studimore dhe bursave për personelin që të familjarizohet me shembuj	- Guidat turistike dhe botimet i përshaten audiencave të ndryshme – fëmijëve, studentëve universitarë, publikut të përgjithshëm, turistëve, etj që zbatohen duke përdorur dokumentet standarde të përgatitura - Materiale trajnuese për deputetët, personelin parlamentar, aktivitete të kontaktit me publikun, duke u bazuar në modelet e përdorura nga Shërbimi Parlamentar Zviceran, Instituti Parlamentar maqedonas, dhe parlamentet skoceze/angleze, sllovaqe dhe çeke	162,969

5. Për qëllimet e marrjes së këshillave nga eksperti për Këshillin Drejtues (KD), Bordi Këshillimor i Projektit mund të ngrihet pas konsultimeve me KD-në. Një model i mundshëm mund të përfshijë përfaqësuesit e Grupit të Punës për Donatorët e Kuvendit, përfaqësuesit e parlamentit sllovak, dhe çek, atij maqedonas dhe parlamentit të Konfederatës Zvicerane

6. Parashikohet që Plani Strategjik të hartohet dhe miratohet në korrik 2019, që do të mundësojë menjëherë fillimin e planifikimit strategjik për IP-në.

AZZHB Rezultati 2: Parlamenti i përfaqëson më mirë zgjedhësit dhe i kërkon llogari degës ekzekutive duke përmirësuar funksionet e tij legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese

- **IKD rezultati 1:** Deputetët janë të pajisur më mirë për të ushtruar funksionet e tyre legjislative dhe mbikëqyrëse përmes përdorimit në kohë, e të paanshëm të kërkit objektiv dhe analizës së sigurtuar, dhe
- **IKD rezultati 2:** Shërbimet administrative (media/kontakti me publikun, zyra e projekteve dhe botimet) kontribuojnë në rritjen e transparencës së operacioneve të parlamentit.

	të edukimit parlamentar dhe veprimtaritë e kontaktit me publikun (Mbretëri e Bashkuar, Skoci, Zvicër me bashkëpunimin e Shërbimit Parlamentar zviceran) Zhvillimi i seminareve orientuese/konsultim eve për deputetët e rinj, personelin parlamentar, grupin e këshilltarëve parlamentarë, asistentët e elektoratit	Shërbimi edukativ organizon seanca orientimi dhe informimi për deputetët e rinj, personelin parlamentar, ekspertët e jashtëm, grupin e asistentëve parlamentarë, stazhierët, si dhe organizon trajnime për çështje të caktuara për personelin administrativ	
Qendra e Vizitorëve IKD-ja ka identifikuar një mjedis potencial ngjitur me Sallën Plenare të parlamentit, që do të shërbejë si një qendër shumë-funksionale për vizitorët, për ekspozita, edukim, trajnime, dhe evente të tjera. IKD-ja do të kërkojë miratimin e Kuvendit për adaptimin e kësaj hapësire.	- IKD-ja do të kontraktojë projektuesit për të shfrytëzuar maksimalisht mjedisin fizik, dhe pas miratimit nga parlamenti, do ta mobilojë atë me teknologjinë dhe mobilitet e nevojshme që të përdoret gjatë guidave parlamentare dhe ditëve të hapura - Mbështetja për ngritjen e grupit parlamentar të punës për transparencën legjislativë - Hartimi i një plan veprimi të hapur parlamentar në përputhje me standardet ndërkombëtare për transparencën e hapur - Konferencë kombëtare për transparencën legjislativë të hapur që do të diskutojë me grupet e	- Qendra operacionale për vizitorët, për pritjen e qytetarëve gjatë guidave parlamentare, organizimi i ekspozitave me tematikë të caktuar dhe zhvillimi i aktiviteteve për edukimin qytetar - Ngritja dhe funksionimi i grupit të punës ndër-partiak dhe ndër-sektorial - Plani i Veprimit për parlamentin e hapur që do të plotësojë standardet ndërkombëtare për transparencën e hapur legjislativë, të miratuar e të promovuar nga udhëheqja e parlamentit.	51,120
Grupi i Punës për Transparencën e Hapur Legjislativë Duke pasur parasysh përvojën rajonale dhe ndërkombëtare të IKD-së në mbështetjen e transparencës së hapur legjislativë parlamentare, dhe në varësi të interesit të Kuvendit të Shqipërisë, IKD-ja do ta mbështesë Kuvendin e Shqipërisë që të fillojë			75,346

hartimin e një plani veprimi për transparencën e hapur legislative sipas standardeve ndërkombëtare. Shërbimi Parlamentar Zviceran (SHPZ)	shoqërisë civile dhe qytetarët për strategjitë e reja, mjetet, apo praktikat për parlamentin e hapur • IKD-ja do të sponsorizojë një sondazh publik për të marrë mendimet e qytetarëve mbi punën e Kuvendit, dhe transparencën e hapur legislative, që do të ndihmojnë administratën të caktojë edhe fushat prioritare për përmirësimin e Kuvendit të hapur. Sondazhi publik do të bëhet vitin e parë dhe të tretë. Aktivitetet e SHPZ-së në IKD do të zhvillohen nga SHPZ-ja në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë.		48,564
---	---	--	---------------

IKD-ja do të sigurohet që të promovohen parimet e barazisë gjinore nga deputetët dhe personeli parlamentar. Ato do të integrohen gjatë të gjithë procesit të themelimit dhe zhvillimit të Institutit Parlamentar, në shërbimet e këtij instituti.

7. IKD-ja ka bashkë-kryesuar Grupin e Punës për Partneritetin e Qeverisjes së Hapur Legislative për të mbështetur parlamentet partnere nëpër botë, në mënyrë që të përcaktohet apo zbatohen angazhimet lidhur me parlamentin e hapur sipas planeve kombëtare të veprimit të vendeve të tyre. IKD-ja ka lehtësuar formimin e e- Rrjetit për Parlamentin e Hapur (OPeN), një shoqëri me shumë partnerë që punon me grupin e punës për qeverisjen e hapur për të siguruar mundësi të vazhdueshme në angazhimin e transparencës së hapur parlamentare.

Përmbledhja e Projektit

Projekti për Asistencën e Kuvendit dhe Edukimin Qytetar
(PACEP)



Struktura e Projektit

[illegible]

Organization for Security and
Co-operation in Europe

KOSTOJA E PËRGJITHSHME E PROJEKTIT € 2.299,466

Rezultati 1

Administrata e kuvendit i përmbush funksionet e saj në mënyrë efektive dhe bindëse

Rezultati 2

Kuvendi përmbush funksionet e tij legjislativ, mbikqyrës dhe përfaqësues duke i përfaqësuar më mirë zgjedhësit dhe duke i kërkuar llogari degës ekzekutive

Rezultati 3

Qytetarët fitojnë vendin e tyre në zhvillimet demokratike të vendit, janë të përgatitur t'u kërkojnë llogari deputetëve dhe luajnë rol aktiv për të ndikuar tek reformat

OSCE

Organization for Security and
Co-operation in Europe

Rezultati 1A

Personeli administrativ i kuvendit punon sipas kuadrit të përmirësuar strategjik, operacional dhe buxhetor të punës

Aktiviteti 1A.1

Promovon autonominë financiare dhe administrative të Kuvendit

Aktiviteti 1A.2

Zhvillon Planin Strategjik për Kuvendin

Aktiviteti 1A.3

Mbështet përmirësimin e menaxhimit më të mirë të burimeve njërezore të administratës së Kuvendit

Aktiviteti 1A.4

Mbështet mundësitë e të mësuarit nga kolegët nëpër parlamentet evropiane lidhur me shërbimet administrative

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 94,280	€ 47,140	€ 38,700	€ 30,700	€ 210,820

OSCE

Organization for Security and
Co-operation in Europe

Rezultati 1B

Një proces pune i integruar dhe transparent legjislativ përmirëson qasjen në ligjet e konsoliduara dhe të dhënat e kuvendit

Aktiviteti 1B.1

Mbështet një sistem të integruar e-Legjislacion

Aktiviteti 1B.2

Mbështet disponueshmërinë e legjislacionit të konsoliduar

Aktiviteti 1B.3


Dixhitalizon të dhënat e shkuara të kuvendit dhe i integron në sistemin e-Legjislacion

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 171,260	€ 206,360	€ 83,860	€ 78,500	€ 539,980



Organization for Security and
Co-operation in Europe

Sistemi E-Legjislacion



Rezultati 2A

Deputetët kanë më shumë njohuri për përmbushjen e funksioneve të tyre legjislative, mbikqyrëse dhe përfaqësuese

Aktiviteti 2A.1

Promovon modelet e praktikave më të mira për komisionet

Aktiviteti 2A.2

Forcon bashkëpunimin e Kuvendit me Institucionet e Pavarura

Aktiviteti 2A.3

Forcon rolin e Kuvendit në monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit

Aktiviteti 2A.4

Forcon rolin e kuvendit në punën me çështjet gjinore

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 63,944	€ 80,764	€ 42,940	€ 40,760	€ 228,408

OSCE

Organization for Security and
Co-operation in Europe

Rezultati 2B

Deputetët përfitojnë burime dhe mjete të reja për të përmirësuar efikasitetin e tyre legjislativ

Aktiviteti 2B.1

Zhvillimi i e-Legjislacionit për deputetët nëpërmjet aplikacionit në telefonin celular

Aktiviteti 2B.2

Mbështetja përgatitjen e fizibilitetit për sistemin e ri të votimit në sallën plenare

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 20,000	€ 40,000	€ 21,960	€ 11,960	€ 93,920



Organization for Security and
Co-operation in Europe

Rezultati 3A

Grupet e shtetara të shoqërisë civile kanë rritur kuptueshmërinë e tyre dhe qasjen në kuvend dhe proceset demokratike

Aktiviteti 3A.1

Fuqizimi i angazhimit të shoqërisë civile me Kuvendin dhe mbështetja e aktiviteteve me publikun për demokracinë dhe të drejtat e njeriut

Aktiviteti 3A.2

Përmirësimi i mundësive për edukimin e votuesve

Aktiviteti 3A.3

Zhvillimi i junistëve të Kuvendit dhe atyre qeveritare të brezit të ardhshëm

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 43,400	€ 26,940	€ 26,960	€ 26,960	€ 124,260

OSCE

Organization for Security and
Co-operation in Europe

Rezultati 3B

Kuvendi rrit kontaktin me qytetarët nëpërmjet medias

Aktiviteti 3B.1

Mbështet disponueshmërinë e përmbajtjes së programit lidhur me çështjet parlamentare

Aktiviteti 3B.2

Zgjeron kapacitetin e medias për të ndërruar e për të raportuar për Kuvendin

Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	TOTALI
€ 48,060	€ 23,060	€ 19,000	€ 19,000	€ 109,120

Organigrama për Menaxhimin e Projektit PACEP

Prania e OSBE-së

Menaxhimi dhe Administrimi

Njësia e Administrimit të Fondit

Njësia e Koordinimit të Projektit

Njësia e Çështjeve Politike dhe Publike

Sekretariati i OSBE-së

Prania e OSBE-së

Programet Tematike

Departamenti i Sundimit të Ligjit dhe
Të Drejtave të Njeriut

Departamenti i Qeverisjes në Çështjet
Ekonomike dhe Mjedisore

Departamenti i Bashkëpunimit dhe
Sigurisë

Zyra e OSBE-së për Institucione
Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

Asambleja Parlamentare e OSBE-së
Parlamentet Evropiane dhe Institucione
të Tjera

DEPARTAMENTI I DEMOKRATIZIMIT TË PRANISË SË OSBE-së (Fondet UB)

Njësia Mbështetëse e Asamblesë

Oficeri Kombëtar i Programit

MENAXHERI I PROJEKTIT PACEP

Asistenti i Programit

Njësia e Reformës Zgjedhore

Njësia e Zhvillimit të Medias

Njësia e Shoqërisë Civile dhe
Çështjeve Gjimore

MENAXHIMI I PROJEKTIT PACEP (ExB Fonde zvicerane)

ADMINISTRATA

Asistenti Kryesor i Financave

Asistenti Administrativ/Përkthyesi

AKTIVITETET E PROJEKTIT

Specialisti Ligjor

Specialisti i IT-së

Specialisti i Burimeve Njerëzore

Specialisti i Kontaktit me Publikun/
Median

Këshilltarët e Jashtëm dhe Ekspertët
Afatshkurtër

Legjenda:

Drejtikëndësh i kuq: Zyra e Menaxhimit të Projektit	Linja e drejtpërdrejtë e kontrollit menaxherial
Drejtikëndësh i bardhë:	Linja e administratës apo mbështetjes së programit
Drejtikëndëshi blu:	Struktura e Pranisë së OSBE-së në Shqipëri
Drejtikëndëshi gri:	Mbështetja e Menaxhimit për Projektin
Drejtikëndëshi bojë qielli:	Mbështetja Tematike për Projektin